



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Qytetërim Grek

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore, 4 kredite; 20 leksione, 20 seminare;
Viti / Semestri : Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të aftësojë studentin në rishprehjen në gjuhë të huaj të të gjitha të dhënave dhe materialeve me karakter historik mbi historinë e Qytetërimit grek, ku aktiviteti i tij mendor në përpunimin e mendimit kritik në rrethanat historike dhe në zhvillimin e civilizimit zë vendin kryesor. Shkathtësimi i të menduarit dhe të shprehurit në gjuhën e huaj mbi një bosht të përcaktuar ideor, formëson studentin në mbajtjen e një rendi logjik në ligjërimin e tij dhe në racionalitetin e përdorimit sa më të saktë të gjuhës greke. Përtej sa më sipër, studenti informohet me elementet e historisë së civilizimit përmes së cilave ka kaluar Greqia dhe se çfarë rezultatesh sollën këto elemente në popullin grek, në vendet fqinje e më gjerë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Aftësi për të fituar koncepte fillestare të historisë së qytetërimit grek.
2. Aftësi për të komunikuar në situata të ndryshme jo shumë të vështira.
3. Njohuri mbi fakte historike.
4. Aftësi për të treguar për gjëra mjaft të vështira nga ana gjuhësore.
5. Aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.
6. Aftësi për të marrë vendime